



Funded by  
the European Union



# RAPORT

**NEVOJAT E OSHC-VE LOKALE  
PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE  
ME QËLLIM RITJEN E ROLIT MBIKËQYRËS  
NDAJ INSTITUCIONEVE PUBLIKE**





Shtator, 2023

**Disclaimer:** Ky publikim u mbështet financiarisht nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Together for Life dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

© Together for Life, Tiranë, Shqipëri 2023. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

### **Eksperte e Studimit**

Erisa Proko

### **Grupi i Punës**

Erisa Proko

Merita Myftari

Alma Lahe

Autor: © TOGETHER FOR LIFE  
Rr. Brigada VIII, Pallati Jeshil –Tekno Projekt  
Shk.2, Ap.13  
Tiranë, Shqipëri  
Email: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)  
Web: [www.togetherforlife.org.al](http://www.togetherforlife.org.al)

## Tabela e përmbajtjes

<b>Përmbledhje ekzekutive</b> .....	6
Roli i OSHC-ve në mbikëqyrjen e institucioneve dhe në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri.	6
<b>Nevojat e OSHC-ve për rriten e kapaciteteve të brendshme</b> .....	9
<i>Metodologjia</i> .....	10
<i>Kufizimet e vlerësimit</i> .....	11
<i>Informacion i përgjithshëm mbi OSHC-të</i> .....	12
<i>Profili i OSHC-ve të përfshira në studim</i> .....	13
<b>Kuadri institucional dhe organizativ i OSHC-ve</b> .....	21
<i>Nevojat/sfidat me të cilat përballen OSHC-të</i> .....	23
<b>Pjesëmarrja e organizatave në nisma që synojnë fuqizimin e qytetarëve</b> .....	31
<i>Konsultimi publik dhe aksesimi në informacion</i> .....	36
<b>Konkluzionet</b> .....	43
<b>Rekomandime</b> .....	45
Bibliografia .....	47

# INDEKSI I GRAFIKËVE

- Grafiku 1:** Numri i OSHC-ve që operojnë në Shqipëri të ndara sipas statusit të tyre
- Grafiku 2:** Numri i OSHC-ve aktive të ndara sipas Drejtorive Rajonale të Tatimeve
- Grafiku 3:** Shpërndarja gjeografike e OSHC-ve sipas rajoneve
- Grafiku 4:** Shpërndarja e OSHC-ve sipas vitit të themelimit
- Grafiku 5:** Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve
- Grafiku 6:** Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve sipas rajoneve
- Grafiku 7:** Shtrirja në territor e organizatave
- Grafiku 8:** Staf i brendshëm dhe i jashtëm sipas rajoneve
- Grafiku 9:** Numri i punonjësve me pagë
- Grafiku 10:** Punësimi sipas gjinisë
- Grafiku 11:** Politikat dhe dokumentet e brendshme të miratuara
- Grafiku 12:** Nevojat/Sfidat me të cilat përballen OSHC-të sipas rajonit ku veprojnë
- Grafiku 13:** Ekzistenca e politikave që parashikojnë ngritjen e kapaciteteve të stafit të organizatës
- Grafiku 14:** Format e përdorura nga organizata për rritjen e kapaciteteve të stafit sipas rajonit
- Grafiku 15:** Hera e fundit kur stafi i organizatës ka marrë pjesë në trajnime
- Grafiku 16:** Fushat e trajnimit sipas vjetërsisë së organizatës
- Grafiku 17:** Fushat e trajnimit sipas rajonit ku vepron organizata
- Grafiku 18:** Nevojat e organizatave sipas vlerësimit të tyre (1- nevojë shumë e lartë, 5- nevojë e papërfillshme)
- Grafiku 19:** Mjetet që përdor organizata për të vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me bazën e mbështetësve
- Grafiku 20:** Format e përdorura për identifikimin e nevojave të grupeve që përfaqësojnë organizatat
- Grafiku 21:** Përfshirja e organizatave në nisma që kanë në themel fuqizimin e qytetarëve për t'u përfshirë në procese demokratike të drejtpërdrejta
- Grafiku 22:** Përfshirja e organizatave në procese advokimi për çështje lokale
- Grafiku 23:** Përfshirja e organizatave në fushata advokimi të ndërmarra nga një ose disa organizata
- Grafiku 24:** Bashkëpunimi me organizatat e tjera
- Grafiku 25:** Mjetet që përdorin organizatat për ndërtimin e partneriteteve
- Grafiku 26:** Kategorizimi i çështjeve për të cilat organizatat kanë advokuar sipas fushave
- Grafiku 27:** A keni arritur të sillni ndryshime pozitive duke ndikuar në opinionin publik dhe/ose në proceset vendimarrëse?
- Grafiku 28:** Sa e njohin organizatat Ligjin Për Konsultimin Publik?
- Grafiku 29:** Përfshirja e organizatave në konsultime në nivel lokal dhe qendror
- Grafiku 30:** Përfshirja e organizatave në draftimin/diskutimin e projekt-akteve nga Bashkia, Qarku
- Grafiku 31:** Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në konsultimet publike të Buxhetit nga njësitë e vetqeverisjes vendore
- Grafiku 32:** Sa organizata kanë njohuri mbi Ligjin Për të Drejtën e Informimit?
- Grafiku 33:** A i janë drejtuar organizatat me kërkesë/ankesë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale?





## **SHKURTIME DHE AKRONIME**

<b>OSHC</b>	<b>Organizata të Shoqërisë Civile</b>
<b>BE</b>	<b>Bashkimi Evropian</b>
<b>TFL</b>	<b>Shoqata “Together for Life”</b>
<b>INSTAT</b>	<b>Instituti i Statistikave</b>



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport i vlerësimit të nevojave, që fokusohet në Organizatat e Shoqërisë Civile me bazë në komunitet dhe grupet formale/joformale nëpër rajone të ndryshme të vendit, shërben si një hap themelor për planifikimin e hapave për mbështetjen e tyre për të rritur dhe përforcuar kapacitetet në fushën e politikëbërjes, duke avancuar gjithashtu përgjegjësinë dhe llogaridhënien publike të institucioneve shtetërore. Për më tepër, gjetjet e këtij raporti hedhin bazat për formulimin e iniciativave të trajnimit, të përshtatura dhe të orientuara drejt rritjes së aftësive të këtyre organizatave. Fushëveprimi i raportit shtrihet në krijimin e strategjive të avokimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për shqetësimet kritike sociale, veçanërisht në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Kjo qasje gjithëpërfshirëse mbështet zhvillimin e programeve specifike të trajnimit, në përputhje me objektivin për të fuqizuar këto organizata për të nxitur ndryshime domethënëse.

### Roli i OSHC-ve në mbikëqyrjen e institucioneve dhe në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) janë një forcë shtytëse e jashtëzakonshme e ndryshimit në çdo shoqëri, duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e vlerave si shteti ligjor, demokracia dhe të drejtat e njeriut. Organizatat ndërtojnë themelet e qytetarisë aktive dhe angazhimit të qytetarëve, dhe kanë një ndikim të thellë në përmirësimin e cilësisë së jetës shoqërore dhe politike në vend. Zëri i shoqërisë civile duhet të qëndrojë i fortë ashtu si dhe përpjekjet për zhvillimin e shoqërisë dhe përfshirjen e vërtetë të OSHC-ve në procesin e politikëbërjes në Shqipëri, si dhe në llogaridhënien publike të institucioneve shtetërore. Këto përpjekje duhet të fokusohen në rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të OSHC-ve në Shqipëri për të monitoruar dhe marrë pjesë në proceset reformuese në Shqipëri. Po aq i rëndësishëm është edhe forcimi i kapaciteteve të organizatave më pak të zhvilluara dhe atyre me bazë në komunitet (grassroot).

Një shoqëri civile e përfshirë dhe aktive duhet të ketë aftësinë të marrë përsipër përgjegjësinë për të mbikëqyrur institucionet publike, të paraqesë zgjidhje politike dhe të krijojë një platformë për qytetarët për të ngritur zërin në mbrojtje të të drejtave e tyre. Mobilizimi dhe angazhimi i tyre i pandërprerë ka një rol vendimtar në përballimin e sfidave që lidhen jo vetëm me avancimin e procesit të integritetit të Shqipërisë në familjen evropiane, por edhe për monitorimin e zbatimit të reformave (madhore) si dhe adresimin e çështjeve të llogaridhënies së qeverisë, si në nivelin qendror ashtu edhe atë vendor. Lufta kundër korrupsionit në Shqipëri mbetet një nga sfidat kryesore të shoqërisë dhe qeverisë. Edhe pse janë bërë disa përpjekje për të adresuar këtë problem, ende ka shumë punë për të bërë për të reduktuar nivelin e korrupsionit në vend, si dhe për të ndërtuar një shoqëri më të integruar, më të përgjegjshme dhe transparente.



Roli i organizatave të shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit është thelbësor. Shoqëria civile duhet të jetë e pavarur nga qeveria dhe biznesi, dhe të punojë për të përmbushur nevojat dhe interesat e qytetarëve. Duke luajtur një rol kyç në nxitjen e transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies, duke monitoruar në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme veprimet e institucioneve publike në sektorë të ndryshëm për të zbuluar raste të dyshimta të korrupsionit, duke raportuar publikisht për gjetjet e tyre dhe duke bërë presion për llogaridhënien e institucioneve dhe zyrtarëve përgjegjës, ato ndihmojnë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Vetëm nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta dhe vendosjes së parimeve të përgjegjësisë, Shqipëria mund të arrijë një përparim të qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit dhe në konsolidimin e shtetit të së drejtës. Për të përballuar sfidat e korrupsionit duhet të ketë përpjekje të vazhdueshme dhe koordinim i përbashkët nga institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022<sup>1</sup> thekson se Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit, por nevojitet ende më tepër vullnet politik, përpjekje më të strukturuar, si dhe burime e aftësi më të përshtatshme. Në përgjithësi, pavarësisht progresit të shënuar, korrupsioni mbetet fushë që sjell shqetësime serioze. Në këtë raport gjithashtu evidentohet fakti se masat anti-korrupsion vazhdojnë të kenë ndikim të kufizuar në fusha veçanërisht të ndjeshme, si **shëndetësi, arsim, tatime, prokurim publik etj.** dhe ai mbetet dominant në këta sektorë vulnerabël dhe me prirje më të mëdha për korrupsion.

Sipas Raportit Screening për Shqipërinë 2023<sup>2</sup>, në përgjithësi, ekziston kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për OSHC-të, por zbatimi duhet të përforcohet më tej, veçanërisht për procedurat e regjistrimit. Proceset e konsultimit duhet të përmirësohen për t'u bërë më gjithëpërfshirëse dhe për të mundësuar një mjedis të favorshëm, pasi konsultimet publike me shoqërinë civile dhe grupet e interesit dhe ndërveprimi me OJQ-të/OSHC-të dhe grupet e interesit janë përgjithësisht formale. OJQ-ve/OSHC-ve dhe grupeve të interesit duhet t'u jepet fuqizim më i madh dhe përfshirje në kohë për të dhënë kontribute kuptimplotë.

Në raportin e vlerësimit “Pjesëmarrja e OSHC-ve në Vendimmarrje në Shqipëri”, hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), del në pah mungesa e vullnetit politik për të realizuar procese të vërteta konsultimi dhe për të përmirësuar bashkëpunimin mes OSHC-ve dhe institucioneve. Institucionet shtetërore nuk e konsiderojnë angazhimin me OSHC-të si të rëndësishëm për promovimin e interesit publik, por më tepër si një barrë tjetër pune pa ndonjë ndikim të madh. Rrjedhimisht, kjo gjë rrit edhe më shumë mosbesimin e ndërsjellë mes institucioneve publike dhe OSHC-ve në lidhje me bashkëpunimin dhe ndikimin e tij, që çon në kulturën (tick the box) ose e “bërjes së gjërave sa për të kaluar radhën”.

Edhe pse angazhimi i shoqërisë civile është me rëndësi kritike, nga vlerësimi i bërë në terren në kuadër të këtij raporti, pjesa më e madhe e organizatave vuajnë nga kapacitetet e pamjaftueshme, kanë mangësi në burime dhe në të kuptuar të problematikave për të pasur një ndikim të rëndësishëm, përveç disa OSHC-ve të konsoliduara tashmë. Prandaj, ndonëse OSHC-të në nivelin vendor kanë lidhje më të forta me

<sup>1</sup>[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)

<sup>2</sup>[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en)

komunitetin, ato kanë kufizime të konsiderueshme për sa i përket strukturave, burimeve dhe kompetencave të duhura për të ndërvepruar në mënyrë të qëndrueshme dhe kuptimplote me vendimmarrësit<sup>3</sup>.

Nga ana tjetër, Raporti i “Transparency International” në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit në vend, evidenton faktin se shumica e vendeve pjesëmarrëse në këtë indeks po dështojnë në përpjekjet e tyre për të reduktuar korrupsionin. Shqipëria për vitin 2022 renditet shumë poshtë në listë, në vendin e 101 nga 180 vende me 36 pikë nga 100.

Qeveria Shqiptare në dokumentet e politikave publike strategjike si dhe në Planet e Integritetit si mekanizma në luftën kundër korrupsionit, në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, njeh rolin që luan shoqëria civile dhe angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave, strategjive apo ligjeve për fushat përkatëse të përgjegjësisë<sup>4</sup>.

Në këtë kontekst, shoqëria civile funksionon si një ndërfaqe midis qytetarëve dhe institucioneve publike, duke sjellë ndërveprimin dhe dialogun konstruktiv. Përmes monitorimit të veprimeve të institucioneve publike, ajo siguron llogaridhënie dhe ndikon në ndryshime pozitive. Propozimi i zgjidhjeve politike dhe kontributi në formulimin e politikave të ndryshme ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave komplekse shoqërore dhe ekonomike.

Shoqëria civile gjithashtu promovon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset demokratike. Ajo krijon platforma për shprehjen e shqetësimeve dhe mendimeve të qytetarëve, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror dhe politik. Një shoqëri e tillë e përfshirë është e rëndësishme për të krijuar një ndryshim të qëndrueshëm në kulturën politike dhe në mënyrën e veprimit të institucioneve publike. Për suksesin e Shqipërisë në procesin e integrimin evropian, për zbatimin e reformave dhe për përmirësimin e llogaridhënies së qeverisë, një shoqëri civile e fortë dhe aktive është vendimtare. Kjo lloj shoqërie jo vetëm që përcakton një sferë të rëndësishme të qytetarisë, por gjithashtu kontribuon në ndërtimin e një Shqipërie më të qëndrueshme dhe demokratike.

Përpjekjet për zhvillimin e shoqërisë civile dhe përfshirjen e vërtetë të OSHC-ve në politikëbërje duhet të përqendrohen në rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit të tyre. Kjo përfshin trajnime, shkëmbim të përvojave dhe mbështetje financiare për të lejuar OSHC të bëhen aktive më të fuqishme dhe të ndikojnë më shumë në proceset shoqërore dhe politike. Është e rëndësishme të theksohet fakti se fokusi duhet kthyer edhe drejt organizatave më pak të zhvilluara, të cilat veprimtarinë e tyre e kanë të ndërlidhur pazgjidhshmërisht me komunitetet në të cilat jetojnë dhe punojnë. Përmirësimi i kapaciteteve të këtyre organizatave është një pikë kritike e cila ka nevojë të menjëhershme për adresim dhe ndërhyrje. Këto organizata janë shpesh të vendosura në komunitete të ndryshme dhe kanë një qasje të qëndrueshme dhe të thellë në sfidat e tyre unike. Përkrahja për këto organizata do të sigurojë që zëri i të gjitha segmenteve të shoqërisë të jetë i pranishëm në dialogun shoqëror dhe politik.

<sup>3</sup><https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>

<sup>4</sup>[https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Kombetare-e-Shendetesise-2021-2030\\_compressed.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Kombetare-e-Shendetesise-2021-2030_compressed.pdf)

<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/urdher-nr.-267-per-miratimin-e-planit-te-integritetit-te-MSHMS-2022-2025.pdf>

<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/PI-e-Risqeve-MAS-26-04-22.pdf>

<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>



## Nevojat e OSHC-ve për rritjen e kapaciteteve të brendshme

Përmes përmirësimeve në zhvillimin organizativ, avokimin politik dhe menaxhimin financiar, organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri mund të rrisin ndikimin e tyre në shoqëri dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokratik të vendit. Nevoja për përkrahje teknike, financiare dhe institucionale është shprehur si një faktor kyç për të forcuar kapacitetet e tyre dhe për t'u siguruar që ata të jenë të qëndrueshëm në punën e tyre të rëndësishme në shoqëri.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, organizatat duhet të përqendrohen në forcimin e zhvillimit organizativ dhe të investojnë në zhvillimin e aftësive të anëtarëve dhe stafit. Ato duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre për avokim dhe ndikim politik, duke krijuar lidhje me organizatat e tjera të shoqërisë civile dhe të forcojnë bashkëpunimin me institucionet relevante. Nevojitet një përkrahje teknike e shtuar dhe trajnime për të përmirësuar menaxhimin e projekteve dhe aftësitë financiare.

Disa nga rekomandimet e raportit fokusohen në intensifikimin e përpjekjeve për OSHC-të me bazë në komunitet, për rritjen e mëtejshme të ndërgjegjësimit të komunitetit dhe grupet e interesit që përfaqësojnë mbi fenomenin e korrupsionit në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, ofrimin e shërbimeve publike, avokimin dhe pjesëmarrjen aktive në procesin e vendimmarrjes, kryesisht në nivel vendor. Po ashtu, OSHC-të duhet të punojnë për të rritur kapacitetet e tyre për të dhënë kontribut konkret në proceset e konsultimit publik në nivel vendor të projekt-akteve ligjore dhe nënligjore, buxheteve vendore të bashkive ku operojnë dhe krijimin e aleancave strategjike me OSHC të tjera që veprojnë në fusha që lidhen direkt apo indirekt me shëndetësinë dhe arsimin.

OSHC-të duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre në marrëdhëniet me publikun, hartimin e strategjive të komunikimit, si dhe përdorimin e teknologjisë, duke përfshirë rrjetet sociale dhe platformat online, të cilat ndihmojnë në mobilizimin e rinisë dhe komunitetit për të rritur angazhimin në luftën kundër korrupsionit dhe për të ndikuar në politikat dhe proceset vendimmarrëse. OSHC-të mund të krijojnë fushata online, sondazhe dhe aplikacione për informim dhe ndërgjegjësim. Ato kanë nevojë të orientojnë përpjekjet e tyre drejt rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të tyre drejt rolit mbikëqyrës dhe monitorues për t'i kërkuar llogari institucioneve shtetërore si në nivel vendor por edhe qendror, duke forcuar në të njëjtën kohë pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse.

Gjithashtu, OSHC-të aktive në procesin avokues dhe konsultimit publik duhet të forcojnë kapacitetet në diversifikimin dhe konsolidimin e ekspertizës që ofrojnë, me qëllim sigurimin e një qëndrueshmërie institucionale të brendshme të OSHC-ve.



## PARATHËNIE PËR STUDIMIN

Ky vlerësim ka si qëllim kryesor analizimin dhe vlerësimin e situatës aktuale të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, qofshin ato me bazë në komunitet apo grupet formale/joformale që operojnë në rajone të ndryshme të vendit. Një nga pikat kyçe që analizohet është zhvillimi organizativ i këtyre organizatave, përpjekjet e tyre për të monitoruar, mbikëqyrur, avokuar dhe rritur nivelin e ndërgjegjësimit. Për më tepër, raporti synon të shohë se si organizatat punojnë për forcimin e kapaciteteve të tyre për të kontribuar në procesin e formulimit të politikave publike. Rekomandimet e raportit do të ndihmojnë organizatat të avancojnë në këto fusha dhe të përmirësojnë ndikimin e tyre në shoqëri.

Një pjesë e rëndësishme e vlerësimit përqendrohet në fuqizimin e kapaciteteve të OSHC-ve në drejtim të rolit të tyre mbikëqyrës. Ky aspekt ndihmon organizatat të kenë një ndikim më të madh në proceset vendimmarrëse dhe të sigurojnë që zëri i tyre të dëgjohej në mënyrë efektive. Përmirësimi i përpjekjeve për avokim dhe ndërgjegjësim gjithashtu do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror dhe politik të komuniteteve të ndryshme të cilat organizatat përfaqësojnë. Në fund, vlerësimi ofron rekomandime të realizueshme, me të cilat kërkohet të rriten dhe forcohen kapacitetet e OSHC-ve në mënyrë që ato të ndikojnë më pozitivisht në procesin e politikëbërjes në Shqipëri, përmirësimin e përgjegjësive dhe llogaridhënies publike të institucioneve shtetërore, zhvillimin e strategjive për avokim dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për çështje të rëndësishme shoqërore rreth shëndetësisë dhe arsimit. Nëpërmjet analizës së tyre të thellë dhe rekomandimeve të detajuara, ky raport shërben si një mjet që përmirëson ndërveprimin midis organizatave të shoqërisë civile, institucioneve publike dhe qytetarëve, duke krijuar kështu një rrjedhë të fuqishme të ndryshimit shoqëror dhe politik në Shqipëri.

## METODOLOGJIA

Për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse ky raport vlerësimi përfshiu përdorimin e metodave të përbëra si ato cilësore dhe sasiore. Qasja cilësore përfshiu përdorimin e dy instrumenteve kryesorë, analizën e kuadrit rregullator dhe strategjik në dy sektorët kryesorë, shëndetësi dhe arsim (shqyrtim literature), si strategji, dokumente politikash, raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e OSHC-ve të hartuara nga organizata dhe institucione ndërkombëtare, si dhe zhvillimin e intervistave ballë për ballë dhe me telefon me drejtuesit ekzekutivë të OSHC-ve dhe, në mungesë të tyre, me personat e autorizuar të organizatës.

Burimet e shfrytëzuara për këtë punim u bazuan në literaturën ekzistuese, kërkim në faqet zyrtare të institucioneve, si dhe hulumtimi në internet i studimeve dhe raporteve në nivel rajonal dhe kombëtar. Për këtë raport vlerësimi u përdor gjithashtu metoda sasiore, duke hartuar një pyetësor të thelluar si mjeti kryesor kërkimor për mbledhjen e të dhënave. Kjo metodë u zbatua dhe u administrua nga intervistuesit e TFL, të cilët kryen mbledhjen paraprake të të dhënave.

Pyetësi është një instrument shumë i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të kuantifikuara për identifikimin e nevojave të organizatave lokale të shoqërisë civile, kapacitetet ekzistuese, si dhe sfidat me të cilat ata përballen. Pyetësi i vlerësimit trajton çështje që lidhen më së shumti me zhvillimin institucional dhe organizativ të OSHC-ve të intervistuar, nevojën për trajnime dhe ngritje kapacitetesh në një fushë/sector të caktuar, eksperiencën/kapacitet e OSHC-ve në nisima advokimi, roli mbikëqyrës dhe monitorues i OSHC-ve, përfshirja dhe aktivizimi qytetar, marrëdhënia me pushtetin vendor dhe atë qendror, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve shtetërore dhe roli i OSHC-ve për garantimin e tyre etj.

Ky vlerësim u bazua në intervistimin e 50 organizatave lokale me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, ku si referencë shërbeu ndarja territoriale sipas drejtorive rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor<sup>5</sup> (4 drejtori), që është e njëjtë me ndarjen territoriale sipas drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar.

## KUFIZIMET E VLERËSIMIT

Disa prej kufizimeve të këtij raporti vlerësimi, si gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave dhe gjatë hartimit të tij, lidhen kryesisht me: - numrin e limituar të organizatave të intervistuar (50), - vetëdeklarimin e të dhënave nga ana e OSHC-ve. Ky raport vlerësimi, duke u bazuar në të dhëna të vetëdeklaruar nga OSHC-të, kufizohet nga fakti që të dhënat ofrojnë perceptimet (subjektive) të personave të intervistuar dhe jo ndikimin e tyre objektiv. Gjithashtu vlen të përmendet dhe pamundësia e verifikimit të këtyre të dhënave nëpërmjet burimeve të tjera zyrtare.

Ky vlerësim pati një vëmendje të dedikuar dhe konsideratë etike, duke u fokusuar konkretisht në:

- Dakordësimin për të marrë pjesë në pyetësor, ku të gjithë pjesëmarrësit u informuan për qëllimin e pyetësorit dhe dhanë pëlqimin e tyre për të marrë pjesë në plotësimin e tij;
- Pjesëmarrja vullnetare, pasi pjesëmarrja në këtë pyetësor ishte në baza vullnetare;
- U garantua anonimiteti dhe konfidencialiteti i OSHC-ve;
- Pjesëmarrësit u informuan se të dhënat e mbledhura në këtë proces do të përdoren vetëm për analiza kumulative dhe jo individuale.


<sup>5</sup>Urdhër nr. 155, datë 15.10.2018 i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, ku përcaktohet se Drejtorite Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor kanë seline e tyre në Shkodër (që mbulon qarqet Shkodër, Lezhë, Kukës), Tiranë (që mbulon qarqet Tiranë, Durrës, Dibër), Vlorë (që mbulon qarqet Vlorë, Gjirokastër, Fier) dhe Elbasan (që mbulon qarqet Elbasan, Korçë, Berat).

## Informacion i përgjithshëm mbi OSHC-të

Sektori i OSHC-ve në Shqipëri edhe pse ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë periudhës 2011-2020, vazhdon ende të përballlet me sfida të cilat lidhen me qëndrueshmërinë organizative. Aktualisht në Shqipëri, që nga viti 1993 deri më 31.03.2023, rezultojnë në total **12,572<sup>6</sup>** organizata jo-fitimprurëse të regjistruara dhe që administrohen nga Zyra e Regjistrimit, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Bazuar në të dhënat e fundit të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve deri më 01.06.2023, në Shqipëri **operojnë gjithsej 5,816 organizata jo-fitimprurëse**, nga të cilat vetëm **2,514 organizata janë "aktive"**<sup>7</sup>, 3,062 organizata kanë statusin "pasiv", 181 organizata janë të çregjistruara, 58 organizata kanë bërë kërkesë për çregjistrim dhe 1 organizatë është e deklaruar si e "falimentuar"<sup>8</sup>. Ndërkohë që nuk ka asnjë informacion në lidhje me statusin e 6,756 organizatave të tjera nga totali prej 12,572 të regjistruara në Gjykatë. Grafiku 1 paraqet numrin e OSHC-ve të ndara sipas statusit të tyre.

*Grafiku 1. Numri i OSHC-ve që operojnë në Shqipëri të ndara sipas statusit të tyre*



Nëse organizatat jo-fitimprurëse me status "aktiv" i grupojmë sipas rajoneve, atëherë shohim se shumica dërmuese e tyre, (72 %) janë të përqendruara në rajonin e Tiranës. Rajoni Shkodër numëron rreth 12% dhe

<sup>6</sup>Të dhëna të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në kërkesën e TFL


<sup>7</sup>Status aktiv do të thotë që organizata ka kryer aktivitet për një periudhë tatimore prej 12 muaj të njëpasnjëshëm

<sup>8</sup>Të dhëna të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në kërkesën e TFL



kemi një raport të barabartë ndërmjet rajonit të Elbasanit dhe Vlorës me 8%. Konsideruar këto shifra, rezultun se rajoni (Tiranë-Durrës-Dibër-Elbasan-Korçë-Berat) kryeson me pothuajse 84% të organizatave, ndërkohë që rajoni Vlorë-Fier-Gjirokastrë shënon shifrën më të ulët me 8%. Grafiku 2 paraqet informacion në lidhje me numrin e OSHC-ve aktive të ndara sipas Drejtorive Rajonale të Tatimeve.

**Grafiku 2. Numri i OSHC-ve aktive të ndara sipas Drejtorive Rajonale të Tatimeve**




## Profili i OSHC-ve të përfshira në studim

Ky vlerësim u bazua në intervistimin e 50 organizatave me shtrirje gjeografike në të gjithë vendin. Për analizimin e të dhënave sipas ndarjes gjeografike si referencë shërbeu shpërndarja territoriale e drejtorive rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor<sup>9</sup>.

Analizimi i shpërndarjes së OSHC-ve tregon se përqendrimi më i madh i organizatave të intervistuar e kanë qendrën dhe vepronë kryesisht në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër (32%) dhe në rajonin Elbasan-Korçë-Berat (28%). Ndërsa raporti i shpërndarjes së organizatave midis rajonit Shkodër-Lezhë-Kukës dhe Vlorë-Fier-Gjirokastrë është i barabartë. Grafiku 3 paraqet vizualisht shpërndarjen gjeografike të organizatave sipas rajoneve.

<sup>9</sup>Urdhër nr. 155, datë 15.10.2018 i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, ku përcaktohet se Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor kanë selinë e tyre në Shkodër (që mbulon qarqet Shkodër, Lezhë, Kukës), Tiranë (që mbulon qarqet Tiranë, Durrës, Dibër), Vlorë (që mbulon qarqet Vlorë, Gjirokastrë, Fier) dhe Elbasan (që mbulon qarqet Elbasan, Korçë, Berat).

Grafiku 3. Shpërndarja gjeografike e OSHC-ve sipas rajoneve<sup>10</sup>



Nga analiza e të dhënave të grumbulluara sa i përket periudhës së themelimit të organizatave, vërehet se rreth 65% e tyre janë organizata relativisht të reja, të themeluara pas vitit 2010. Në rajonin Vlorë-Fier-Gjirokastrë organizatat e përfshira në studim kanë një shpërndarje më të balancuar sipas vitit të themelimit (1991-2000 me 30%; 2001-2010 me 30%; 2011-2020 me 40%). Në rajonet e tjera, Elbasan-Korçë-Berat, Tiranë-Durrës-Dibër dhe Shkodër-Lezhë-Kukës, mbizotërojnë organizatat e themeluara në 10-vjeçarin e tretë, respektivisht me 81%, 77% dhe 60%.


Të gjitha organizatat e intervistuar veprojnë kryesisht në zonat urbane të bashkive kryesore të rajoneve përkatëse. Kjo duket se ndodh pasi qytetet kryesore ofrojnë më shumë mundësi në shumë aspekte, si punësimi, arsimi, shërbimet shëndetësore, kulturore dhe infrastrukturën. Ky faktor i bën ato tërheqëse për OSHC-të, pasi ato mund të përfitojnë nga burimet dhe infrastruktura e ofruar. Përqendrimi i OSHC-ve në qytetet kryesore rrit potencialin për bashkëpunim dhe ndërveprim mes organizatave të ndryshme shoqërore dhe ndihmon në krijimin e një kulture rrjetëzimi dhe bashkëpunimi më të thellë, duke rritur ndikimin dhe aftësinë e tyre për të adresuar çështje të ndryshme shoqërore. Gjithashtu, qytetet kryesore janë më të afërta me burime financiare dhe teknologjike. Ky faktor lehtëson aksesin e OSHC-ve në fonde dhe teknologji të ndryshme për të zhvilluar aktivitetet e tyre dhe për të ndikuar në politikat dhe proceset legjislativë. Prirja e përqendrimit krijon një situatë ku qytetet kryesore janë më të fokusuar në zhvillim ekonomik dhe shërbime, duke lënë pas dore zonat më të largëta dhe më të varfër të vendit, kryesisht zonat rurale. Për të zgjidhur disa nga këto sfida dhe për të ndikuar në një mënyrë më të shtrirë në të gjithë vendin, OSHC-të nevojitet të marrin hapa për të thelluar angazhimin e tyre në zonat rurale dhe të largëta, duke përdorur

<sup>10</sup> Analizimi i të dhënave të mbledhura nga intervistimi i OSHC, bazohet në shpërndarjen territoriale të drejtorive rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor: Shkodër, Tiranë, Elbasan, Vlorë si dhe të drejtorive rajonale të arsimit: Lezhë, Durrës, Korçë dhe Fier, të cilat mbulojnë të njëjtin territor.


teknologjinë për të përmbushur distancën gjeografike dhe duke rritur bashkëpunimin mes tyre për të adresuar problemet e popullsisë në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Grafiku 4 paraqet shpërndarjen e organizatave të intervistuar në territor sipas periudhës kohore të themelimit të tyre.

**Grafiku 4: Shpërndarja e OSHC-ve sipas vitit të themelimit**



Organizatave të përfshira në studim kryesisht kanë një fokus të gjerë pune. Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga intervistat, rezultojnë se më pak se 1/10 e organizatave kanë në fokus të punës së tyre vetëm një sektor specifik. Të gjitha organizatat e intervistuar punojnë në më shumë se një sektor dhe merren me çështje ndërsektoriale. 7/10 e organizatave të përfshira në këtë studim (72%) kanë në fokus fëmijët dhe të rinjtë, si dhe fushat e lidhura me to si të drejtat e njeriut. Vetëm pak më shumë se 1/10 e tyre (12%) ose janë organizata mediatike (vetëm një organizatë nga 50 organizatat të përfshira në studim ka deklaruar se është organizatë mediatike), ose kanë në fokus të punës së tyre edhe bashkëpunimin me median (Grafiku 6). Rreth 1/2 e organizatave që kanë në fokus të punës së tyre mbështetjen për grupe specifike si fëmijët, të rinjtë dhe/ose gratë (36 organizata), deklarojnë se janë të angazhuara edhe në çështjet që kanë të bëjnë me sektorin e arsimit (17 organizata). Kryesisht organizatat janë të angazhuara për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve nga grupet vulnerabël në sistemin arsimor, dhe asnjëra prej tyre nuk është përfshirë në aksione të fokusuar në monitorimin e punës së institucioneve arsimore apo që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien në këtë sektor. Nga 8 organizata që deklarojnë se trajtojnë edhe çështje të lidhura me sektorin shëndetësor, gjysma e tyre kanë si fokus kryesor mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, dhe gjysma tjetër janë organizata Rome dhe/ose Egjiptiane. Në lidhje me sektorin shëndetësor, qasja e tyre është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me aksesin e këtyre grupeve në sistemin shëndetësor për marrjen e shërbimeve cilësore. Këto organizata kanë pranuar se deri tani nuk janë përfshirë në aksione që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien e strukturave shëndetësore.




Kryesisht OSHC-të përqendrohen në fusha veprimtarie të lidhura me probleme me ndjeshmëri të lartë për shoqërinë, siç janë çështjet sociale, të drejtat e njeriut, mbështetja për të rinjtë, gratë, fëmijët dhe të moshuarit, etj. Kjo rezulton në përqendrim të aktiviteteve në këto fusha, ndërsa shëndetësia dhe arsimit janë pak ose aspak të përfshira në agjendën e tyre kryesore. Sektorët e shëndetësisë dhe arsimit kërkojnë burime më të mëdha financiare për të ofruar shërbime cilësore dhe me impakt në këto fusha. OSHC-të përballen me kufizime financiare dhe mungesë të fondeve për të zhvilluar projekte dhe programe në këto sektorë, si dhe me mungesë kapacitetesh për të përballuar këto sfida. Gjithashtu, OSHC-të që zgjedhin të angazhohen në këto fusha përballen me sfida të mëdha, si mungesa e burimeve dhe infrastrukturës adekuate, pengesat administrative, dhe ndërveprimin me institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare. Kjo mund të shpjegojë pse ka më pak organizata që trajtojnë këto çështje në mënyrë ekskluzive.

Në rastin e shëndetësisë dhe arsimit, për të promovuar një ndërhyrje më të madhe të OSHC-ve në këto fusha, nevojitet një përpjekje e përbashkët e organizatave, qeverisë dhe partnerëve të tjerë për të siguruar burime dhe mbështetje të mjaftueshme për të adresuar këto sfida dhe për të përmbushur qëllimet e ndryshme shoqërore. Sipas një analize të bazuar në ndarjen rajonale, bie në sy që organizatat që punojnë në rajonin Vlorë-Fier-Gjirokastrë, në krahasim me rajonet e tjera, kanë fokus të veçantë trajtimin e çështjeve gjinore si dhe arsimit në lidhje me politikën për fuqizimin e grave. Vëmendja ndaj çështjeve që lidhen me shëndetësinë janë në vlera shumë të ulëta në rajonin Shkodër (3%), Tiranë (7%), Elbasan (5%), kurse në Vlorë (0%). Vihet re se diapazoni i veprimtarisë së organizatave është shumë i gjerë dhe i larmishëm, duke përfshirë edhe fusha të tjera si mbrojtja e mjedisit, inovacioni, talentet e reja në art, sport, histori, trashëgimi kulturore, bujqësi, blegtori, mbrojtja e konsumatorit, komuniteti LGBTQI, individët abuzues me substanca narkotike, promovimi turizmit etj. Të gjitha këto fusha janë reflektuar tek kategoria “Të tjera”.


Një element tjetër që vërehet në deklaratimet e organizatave të intervistuar është fakti se, të pyetura se sa vëmendje i kushtojnë luftës së korrupsionit në fushat e arsimit dhe shëndetësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë përgjigjur se merren fare pak ose aspak dhe më shumë janë orientuar drejt mirëqeverisjes dhe transparencës. Sektorët e arsimit dhe shëndetësisë janë thelbësorë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqeverisjen e vendit. Mungesa e përqendrimit në këto sektorë lejon përhapjen e fenomenit të korrupsionit, duke u prekur nga mungesa e transparencës dhe llogaridhënies. OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me rrezikun dhe ndikimin e korrupsionit. Mungesa e përqendrimit në këto sektorë krijon boshllëk në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit. Nga ana tjetër, burimet e kufizuara financiare dhe në njerëz për të ndërmarrë fushata specifike kundër korrupsionit në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, ka ndikuar në vendosjen e prioriteteve dhe orientimin drejt fushave më të gjera si mirëqeverisja dhe transparenca.

Për të përballuar këtë situatë, është e rëndësishme që OSHC-të të ndërmarrin hapa për të nxitur ndërgjegjësimin dhe edukimin në lidhje me korrupsionin në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, të nxisin transparencën dhe llogaridhënien në këto fusha, dhe të bëjnë thirrje për veprime specifike që parandalojnë dhe zvogëlojnë korrupsionin. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore, organizatat e tjera dhe donatorët ndihmojnë në forcimin dhe avancimin e këtyre përpjekjeve.

**Grafiku 5: Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve**




**Grafiku 6: Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve sipas rajoneve**



Pjesa më e madhe e organizatave të intervistuar e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel lokal, me një përqendrim më të madh në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër dhe Elbasan-Korçë-Berat me nga 22%, ndërsa Shkodër-Lezhë - Kukës me 12% dhe Vlorë-Fier-Gjirokastrë me 8%. Në nivel kombëtar, Tirana -Durrësi shënon përqindjen më të lartë të organizatave që ushtrojnë veprimtarinë në këtë nivel, me 12 %, krahasuar me rajonet e tjera, ku në Shkodër, Lezhë, Kukës vetëm 8% e totalit të kampionit të organizatave ushtron veprimtari në nivel kombëtar, Elbasan-Korçë 4% dhe Vlorë- Fier 10%. Në rajonin Vlorë-Fier-Gjirokastrë 10% e organizatave nga totali i kampionit kanë deklaruar se ushtrojnë veprimtari në nivel ndërkombëtar, por pa dhënë informacion shpjegues.

Në Grafikon 7 vihet re 85% e organizatave në rajonin Elbasan-Korçë-Berat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel lokal, e ndjekur nga rajoni Tiranë-Durrës-Dibër me 65%, Shkodër-Lezhë-Kukës me 60% dhe në rajoni Vlorë-Fier-Gjirokastrë me 40%. Është interesant fakti se 50% e të gjitha organizatave në rajonin Vlorë-Fier-Gjirokastrë kanë raportuar se ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel kombëtar, e ndjekur me Shkodër-Lezhë-Kukës me 40%, Tiranë-Durrës-Dibër me 35% dhe Elbasan-Korçë-Berat me 15%.

**Grafiku 7: Shtrirja në territor e veprimtarisë së organizatave**




Nga analiza e të dhënave të mbledhura nga kampioni prej 50 organizatash, të pyetura sa i përket stafit të brendshëm dhe të jashtëm që përbëhen nga punonjës me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, vullnetarë dhe ekspertë, rezulton se më shumë se 1/3 (32%) e burimeve njerëzore në organizatat që veprojnë në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës e përbëjnë punonjësit me kohë të plotë, ndërkohë që i dyti renditet rajoni Vlorë-Fier-Gjirokastrë më pak më shumë se 1/5 (21%) e stafit, ndjekur nga rajoni Elbasan-Korçë-Berat me rreth 1/10 (12%). Rajoni Tiranë-Durrës-Dibër paraqitet me përqindjen më të ulët (8%) të punonjësve me kohë të plotë. Duhet theksuar se në Shkodër dhe Vlorë veprojnë qendra komunitare që ofrojnë shërbime multidisiplinare për kategori të ndryshme grupesh vulnerable dhe që kanë të punësuar me kohë të plotë nga 20-40 punonjës. Ndërkohë, përqindjen më të lartë të punonjësve me kohë të pjesshme e ka rajoni Elbasan-Korçë-Berat me 24%, kurse përqindja më e ulët vërehet në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër. Konstatohet se në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër përqindja e ekspertëve të angazhuar nga organizatat është më e lartë krahasuar me rajonet e

tjera, me 23%. Sipas të dhënave, organizatat në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër punojnë kryesisht me ekspertë të jashtëm në kuadër të iniciativave apo projekteve që zbatojnë. Në rajonin Elbasan-Korçë-Berat punonjësit me kohë të pjesshme janë sa dyfishi i punonjësve me kohë të plotë. Në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës dy organizata nuk kanë staf me kohë të plotë, ndërsa një organizatë ka 40 të punësuar me kohë të plotë, asnjë me kohë të pjesshme, asnjë vullnetar dhe asnjë ekspert; në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër, tri organizata në Durrës nuk kanë staf me kohë të plotë dhe janë organizata lokale me fokus çështjet që lidhen me kulturën dhe trashëgiminë kulturore, media, grupet vulnerable; në Tiranë 4 nga 5 organizata të intervistuar kanë në total 205 vullnetarë. Një organizatë në Korçë dhe një në Berat nuk kanë staf me kohë të plotë, ndërsa 9 organizata të tjera nuk deklarojnë asnjë ekspert të angazhuar. Në rajonin Vlorë-Fier-Gjirokastrë, rezulton se 1 organizatë lokale në Lushnjë nuk ka staf me kohë të plotë dhe 5 organizata të tjera në këtë rajon nuk kanë ekspertë.

Grafiku 8 paraqet informacion në lidhje me raportin punonjës me kohë të plotë/kohë të pjesshme/vullnetarë/ekspertë të angazhuar në organizata në secilin prej rajoneve. Niveli i angazhimit të vullnetarëve në të gjitha rajonet është i lartë, duke variuar nga 44% në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës, deri në 63% në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër, ku në rang vendi rezulton se më shumë se ½ (52%) e personave të angazhuar në organizata janë vullnetarë. Kjo mund të shpjegohet nga disa faktorë, ndër të cilët më i rëndësishmi është financimi, si sfidë kryesore për shumicën e organizatave. Po ashtu, përdorimi i punonjësve vullnetarë mundëson që OSHC-të të ndërtojnë një lidhje të fortë me komunitetin dhe të forcojnë marrëdhëniet e tyre me individët dhe organizatat lokale. Kjo rrit ndikimin dhe përkrahjen e komunitetit ndaj aktiviteteve të organizatës.


**Grafiku 8: Staf i brendshëm dhe i jashtëm sipas rajoneve**



Në lidhje me qëndrueshmërinë e stafit të brendshëm, rezulton se 7 organizata kanë një numër mesatar prej 6-15 punonjësish, 6 organizata nuk kanë asnjë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa 2 organizata kanë mesatarisht 16-50 punonjës me kohë të plotë. Organizatat të cilat kanë raportuar se nuk kanë staf janë organizata lokale të cilat merren kryesisht me çështje të komunitetit rom/egjiptian (5 organizata) ose janë degë të organizatave kombëtare të cilat kanë fushë veprimtarie personat me aftësi ndryshe (1 organizatë).


Këto organizata nuk kanë burime të qëndrueshme të ardhurash dhe aktivitetin e tyre e zhvillojnë nëpërmjet stafit që punon me kohë të pjesshme (në varësi të projekteve që zbatojnë) si dhe vullnetarëve. Dy OSHC-të që kanë deklaruar 16-50 staf me kohë të plotë janë organizata që ofrojnë shërbime sociale dhe psikologjike për kategoritë vulnerabël.

**Grafiku 9: Numri i punonjësve me pagë**



Nga këndvështrimi gjinor, rezulton se gratë dhe vajzat dominojnë tregun e punës në organizata, ku 2 në 3 të punësuarve me kohë të plotë janë gra/vajza (73%), ashtu siç pritej, pasi është pranuar se ky sektor dominohet nga gratë dhe vajzat. Në Grafikon 10 vërehet po ashtu se më shumë se gjysma (53%) e të punësuarve me kohë të pjesshme janë gra/vajza; 3 në 5 ekspertë të kontraktuar nga organizatat (59%) janë gra/vajza. I vetmi tregues i cili qëndron i përmbysur dhe befasues është kategoria e vullnetarëve, e cila rezulton dukshëm e dominuar nga djemtë dhe burrat në masën 87%, kundrejt vetëm 13% që janë gra/vajza. Kur vlerësojmë të dhënat sipas 4 rajoneve, rezulton se rajoni Elbasan-Korçë-Berat ka përfaqësim më të balancuar gjinor në punësim, në raportin 45% të punësuar me kohë të plotë burra/djem, kundrejt 55% gra/vajza. Rajoni më pak i balancuar rezulton rajoni Vlorë-Fier-Gjirokastrë, ku për çdo katër të punësuarra gra/vajza është 1 i punësuar burrë/djalë.

**Grafiku 10: Punësimi sipas gjinisë**





## Kuadri institucional dhe organizativ i OSHC-ve

Zhvillimi organizativ i OSHC-ve është një proces i rëndësishëm që ndikon në aftësinë e tyre për të realizuar qëllimet dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Në kontekstin e kapaciteteve të kufizuara, disa sfida të veçanta lidhur me zhvillimin organizativ të OSHC-ve përfshijnë planifikimin strategjik, programin/zbatimin projektiv, menaxhimin organizativ, qëndrueshmërinë financiare si dhe rrjetëzimin. Kapacitetet e kufizuara në planifikimin strategjik pengojnë organizatat për të përcaktuar qëllimet afatgjata, strategjitë dhe hapat e nevojshëm për të arritur qëllimet e tyre. Mungesa e një plani të qartë strategjik çon në përdorimin e burimeve në mënyrë të paefektshme dhe në mosarritjen e ndikimit të dëshiruar. Kapacitetet e kufizuara ndikojnë gjithashtu edhe në aftësinë për të zhvilluar dhe zbatuar programe dhe projekte të qëndrueshme. Organizatat hasin vështirësi në identifikimin e nevojave të komunitetit, në planifikimin dhe ndërtimin e programeve efikase dhe në zbatimin e tyre me sukses.


Sipas vlerësimit të të dhënave, rezultojnë se organizatat në përgjithësi kanë të miratuara politika dhe procedura të brendshme organizative, të cilat rregullojnë veprimtarinë e organizatës. Më pak se 2 në 5 organizata të përfshira në studim (18% e organizatave) kanë deklaruar se kanë hartuar dhe miratuar planin strategjik. Shumica e organizatave lokale deklaruan se kanë vështirësi në zhvillimin dhe zbatimin e një plani strategjik të qëndrueshëm, ndërsa disa organizata e shohin më shumë si një përgjigje ndaj kërkesave të donatorëve për programet grantdhënëse. Kjo tendencë tregon se ka sfida në procesin e planifikimit strategjik dhe qëndrueshmërinë e organizatave shoqërore. Disa elementë të rëndësishëm që ndikojnë në këtë situatë përfshijnë: (1) kapacitete të kufizuara për të zhvilluar dhe zbatuar një plan strategjik të qëndrueshëm që mund të jetë për shkak të mungesës së njohurive dhe aftësive të nevojshme për këtë proces. (2) Prioritetet afatshkurtra dhe sfida për mbijetesë: shumica e OSHC-ve janë të fokusuar më shumë në sfidat e mbijetesës dhe zhvillimin e projekteve afatshkurtra për të siguruar financim. Kjo ndikon në përqendrimin e tyre në projektet aktuale dhe kanë më pak resurse për t'u përqendruar në planifikimin strategjik. (3) Ndikimi i donatorëve dhe financimit: disa organizata zhvillojnë plane strategjike në përgjigje të kërkesave të donatorëve, por jo për të arritur qëllime të përgjithshme të zhvillimit. Kjo çon në planifikime të fragmentarizuara dhe të përqendruara vetëm në projekte të veçanta që kërkojnë financim. (4) Ndikimi i përvojës dhe aftësive të stafit: një staf me përvojë dhe aftësi të kufizuara në planifikim strategjik ka gjithmonë vështirësi në zhvillimin dhe zbatimin e një plani të qëndrueshëm.

Për të adresuar këto sfida dhe për të rritur nivelin e planifikimit strategjik të OSHC-ve, nevojiten trajnime dhe mundësi zhvillimi për anëtarët e organizatës që përfshijnë aftësitë e planifikimit strategjik dhe menaxhimit; përmirësimi i kapaciteteve të organizatës në fushën e planifikimit strategjik duke angazhuar konsulentë të jashtëm apo ekspertë për të ndihmuar në procesin; përfshirja e qëndrueshmërisë financiare si një komponent i rëndësishëm i planifikimit strategjik dhe diversifikimi i burimeve të financimit etj. Grafiku 11 siguron të dhëna lidhur me kategori të caktuara të procedurave të brendshme të organizatave, si rregullimi i marrëdhënieve të punës së stafit dhe vullnetarëve, Kodi Etikës, Menaxhimi financiar dhe mbledhja e fondeve, planet strategjike, komunikimi dhe vizibiliteti etj.

Përtej kategorive të listuar në grafikun e mëposhtëm, disa prej organizatave kanë deklaruar se kanë të plotësuar edhe dokumente të tjera strategjike, si: Strategji për mbrojtjen e fëmijëve, dokument për politikat

gjinore të organizatës, dokument për të drejtën e informimit, dokument për konfliktin e interesave, dokument për objektivat e zhvillimit rajonal. Të gjitha këto dokumente janë listuar tek kategoria “Tjetër”. Të pyetur nëse organizata vepron mbi një plan strategji komunikimi ose një dokument tjetër të ngjashëm me të, vetëm 1 në 10 organizata ka pranuar se e ka një dokument të tillë. Ato shprehin nivel të ulët në përdorimin e teknologjisë së informacionit, në administrimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre të përditshme dhe, në mënyrë të veçantë, në nivel shumë të ulët bashkëpunimi me mediat për rritjen e informimit dhe komunikimit me publikun dhe grupet e interesuara.

**Grafiku 11: Politikat dhe dokumentat e brendshme të miratuara**



## Nevojat/sfidat me të cilat përballen OSHC-të

Pavarësisht zhvillimeve, sektori i shoqërisë civile duke qenë një sektor dinamik, ndeshet me një seri sfidash të njëpasnjëshme, duke zhvilluar nevoja të vazhdueshme. Çështjet më sfiduese për organizatat dhe veprimtarinë e tyre, sipas deklaramit të OSHC-ve, janë: (1) Mungesa e fondeve nga donatorët; (2) Mungesë aksesit në fondet publike; (3) Kuadri ligjor dhe fiskal dhe jo-favorizues për OSHC-të; (4) Mungesa e bashkëpunimit me pushtetin vendor; (5) Mungesa e bashkëpunimit me pushtetin qendror; (6) Mungesa e bashkëpunimit me institucionet publike.

Një nga sfidat dhe vështirësitë më të mëdha me të cilat përballen sot organizatat në të gjithë territorin është mungesa e stabilitetit financiar si pasojë e mungesës së fondeve nga donatorët. Rreth 1/3 e organizatave të intervistuar (30%) pranojnë se sfida më e madhe e tyre është mungesa e fondeve, ku sipas rajoneve rezultojnë se në rajonin e Shkodër-Lezhë-Kukës këtë shqetësim e pranojnë 23% e organizatave dhe në rajonin Vlorë-Fier-Gjirokastrë 35%. Organizatat në dy zonat e tjera qëndrojnë ndërmjet këtyre përqindjeve me 29% Elbasan-Korçë-Berat dhe 33% në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër.


Një sfidë tjetër e qenësishme për organizatat lokale është edhe kuadri ligjor dhe fiskal jo-favorizues. Sipas raportit Screening të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2023)<sup>11</sup>, theksohet se në tërësi kuadri ligjor, rregullator dhe institucional OSHC-të është përgjithësisht i plotësuar, por nevojiten një sërë përmirësimesh që kuadri ligjor të zbatohet plotësisht dhe kuadri institucional të bëhet i plotë dhe funksional. Sa i takon regjimit të taksave, Komisioni konstaton se OSHC-të i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të TVSH-së për aktivitetet e tyre tregtare. Ligji parashikon rimbursim të TVSH-së për përfituesit e granteve të BE-së, i cili është rishikuar së fundmi për të siguruar një proces më të shpejtë të rimbursimit, por deri tani nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me zbatimin e tij, çfarë mbetet për t'u vlerësuar në periudhën vijuese.

Nga analizimi i përgjigjeve të organizatave të intervistuar, rezultojnë se për to bashkëpunimi me pushtetin vendor nuk konsiderohet një sfidë, që të bën të mendosh se bashkëpunimi me strukturat e qeverisjes vendore është i kënaqshëm. Kështu, vetëm pak më shumë se 1 në 20 organizata (6.5%) e kanë listuar mungesën e bashkëpunimit me pushtetin vendor si një nga sfidat kryesore me të cilat përballen në aktivitetin e tyre. Më ndryshe paraqitet situata kur e njëjta pyetje bëhet për pushtetin qendror. Rajoni i Vlorës e raportojnë në një përqindje më të lartë si problematikë dhe sfidë bashkëpunimin me pushtetin qendror (15%) në krahasim me rajonin Shkodër dhe Elbasan me 10%, dhe rajonin Tiranë 4%.

Mungesa e bashkëpunimit me institucionet publike deklarohet më shumë në rajonin e Shkodrës (10%) dhe aspak në rajonin e Vlorës. Në mënyrë specifike organizatat që veprojnë në Qarkun Lezhë deklarojnë se ka mungesë të theksuar të bashkëpunimit mes tyre dhe zyrave vendore arsimore, të shëndetësisë dhe të punësimit. Në rajonin e Tiranës, evidentohet se, edhe pse nuk deklarohet që mungesa e bashkëpunimit me pushtetin qendror të jetë sfidë për organizatat, disa organizata deklarojnë pamundësi për të komunikuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kur bëhet fjalë për kërkesa që lidhen me transparencën e fondeve për sektorë të caktuar.

<sup>11</sup>[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en)

**Grafiku 12: Nevojat/Sfidat me të cilat përballen OSHC-të sipas rajonit ku veprojnë**




Në rang vendi, 2 në 3 organizata deklarojnë se kanë politika të brendshme që parashikojnë ngritjen e kapaciteteve të stafit. Në rajonin e Shkodër-Lezhë-Kukës të gjitha organizatat pranojnë se kanë ngritur dhe zbatojnë politika të tilla, ndërkohë që në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër vetëm 2 në 5 organizata (41%) kanë politika për rritjen e kapaciteteve të stafit, Grafiku 6.

Në zonat e Elbasan-Korçë-Berat dhe Vlorë-Fier-Gjirokastrë rreth 3/5 e organizatave deklarojnë se kanë politika për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të tyre. Edhe organizatat që kanë deklaruar se kanë të miratuara politika për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të tyre, nuk japin informacion rreth zbatimit në praktikë të këtyre politikave.

Më shumë se 2/5 e organizatave të përfshira në studim (22%) rritjen e kapaciteteve e mbështesin kryesisht në përfshirjen e stafit në trajnime të ofruara nga donatorët dhe vetëm pak më shumë se 1 në 10 organizata (13%) nëpërmjet trajnimeve në vendin e punës. Organizatat duhet të konsiderojnë rëndësinë e trajnimit afatgjatë dhe zhvillimit të stafit për të përmirësuar kapacitetet e tyre në të ardhmen dhe për të arritur qëllimet e tyre afatgjata.

**Grafiku 13: Ekzistenca e politikave që parashikojnë ngritjen e kapaciteteve të stafit të organizatës**




Në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës, në ndryshim nga rajonet e tjera, rezulton se trajnimet në vendin e punës (18%) dhe trajnimet e ofruara nga donatorët (18%) janë metodat më të përdorura për forcimin e kapaciteteve të stafit të OSHC-ve. Gjithashtu, programet/vizitat e shkëmbimit (16%) dhe trajnimet e ofruara nga vetë organizata (16%) janë përsëri metoda që përdoren më shpesh në këtë rajon.

Ndërkohë, në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër dhe Elbasan-Korçë-Berat, rritja e kapaciteteve të OSHC-ve mundësohet nëpërmjet trajnimeve nga organizata të tjera (21%) dhe trajnime nga donatorët (23%). Rajoni Vlorë-Fier-Gjirokastrë përveç metodave klasike të përdorura nga OSHC-të edhe në rajonet e tjera, përdor edhe trajnimet e ofruara nga vetë organizata (17%).

Përdorimi i metodave të reja të ngritjes së kapaciteteve, si e-learning, edhe pse njihen si metoda efiçente në kohë dhe në kosto, mbetet në nivele të ulëta (5%-8%). Në të njëjtin trend variojnë edhe kurset afatshkurtra brenda dhe jashtë vendit.


**Grafiku 14: Format e përdorura nga organizata për rritjen e kapaciteteve të stafit sipas rajonit**



Kur OSHC-të u pyetën se kur ka qenë hera e fundit që stafi i organizatës ka marrë pjesë në trajnime apo programe për rritje kapacitetesh, rezultoi se gjatë 3-mujorit të fundit kishin marrë pjesë në program trajnimi 70% e organizatave në rajonin e Shkodrës, 59% e organizatave në rajonin e Tiranës, 38% e organizatave në rajonin e Elbasanit dhe 50% e organizatave në rajonin e Vlorës.

Në rajonin e Tiranë–Durrës–Dibër 12% e organizatave deklaruan se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në programe trajnimi dhe 15% në rajonin Elbasan-Korçë. Vihet re është se në përgjithësi organizatat e shtrira në të gjitha rajonet nuk kanë marrë pjesë në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme në programe trajnimi për rritje kapacitetesh.

**Grafiku 15: Hera e fundit kur stafi i organizatës ka marrë pjesë në trajnime**




Përprojekjet për zhvillimin e kapaciteteve të OSHC-ve orientohen kryesisht në trajnime dhe asistencë teknike në lidhje me njohuritë dhe aftësitë bazë mbi zhvillimin e brendshëm të organizatës, siç janë: aftësia e përthithjes së fondeve; shkrimi i projekt-propozimeve; menaxhimi i projekteve; menaxhimi i burimeve njerëzore, si dhe menaxhimi financiar dhe raportimi. OSHC-të ndër prioritetet për ngritjen e kapaciteteve listojnë përtej zhvillimit të brendshëm të organizatës edhe avokimin, pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse, ndërgjegjësimin e komunitetit, mbikëqyrjen dhe monitorimin e institucioneve publike. Interesi për të gjitha këto tema nuk ka diferenca të mëdha ndër organizatat me më shumë vite eksperiencë, apo organizatat e reja (Grafiku 16).


Bazuar në intervistat e kryera me drejtuesit e OSHC-ve, ka qenë i dukshëm një interes i shtuar për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me tematika specifike të sektorëve të shëndetësisë dhe arsimit. Drejtuesit kanë shprehur një kërkesë të qartë për trajnime dhe zhvillim të specializuar në këto fusha, duke theksuar rëndësinë e ngritjes së kompetencave dhe njohurive për të ndikuar në politikat dhe praktikat në këta sektorë. Në bisedat e tyre, drejtuesit e OSHC-ve kanë shprehur kërkesa të përcaktuara për trajnime dhe zhvillim të specializuar. Ata kanë theksuar nevojën për programe trajnimi që të përfshijnë çështje të tilla si menaxhimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, lobimi për ndryshime në politikat e këtyre sektorëve, si dhe hartimin dhe zbatimin e projekteve inovative.

Drejtuesit e OSHC-ve përmendën se formimi i kapaciteteve në shëndetësi dhe arsim do të ndihmojë organizatat të kenë një ndikim më të theksuar në politikat dhe praktikat e këtyre sektorëve, sidomos në nivel vendor, ndihmojnë organizatat të llojnë për ndryshime pozitive, të monitorojnë zbatimin e politikave dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shërbimeve shëndetësore dhe arsimit cilësor.

**Grafiku 16: Fushat e trajnimit sipas vjetërsisë së organizatës**




**Grafiku 17: Fushat e trajnimit sipas rajonit ku vepron organizata**





Sipas vlerësimit të vetë OSHC-ve, rezulton se mbi 2/5 e OSHC-ve kanë nevojë shumë të lartë<sup>12</sup> (1) për rritje të kapaciteteve të stafit në fushat e mbikëqyrjes dhe monitorimit të institucioneve publike, pjesëmarrjes në procesin vendimmarrës, avokimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, por nevoja më e lartë sipas vetë organizatave është për ngritje kapacitetesh që u mundësojnë përfshirjen në procese vendimmarrëse (44%).

**Grafiku 18: Nevojat e organizatave sipas vlerësimit të tyre (1- nevojë shumë e lartë, 5- nevojë e papërfillshme)**




Besueshmëria e OSHC-ve dhe imazhi i tyre në sferën publike janë të ndërlidhura me natyrën e tyre dhe sa të lidhura janë OSHC-të me bazën e tyre të mbështetësve dhe komunitetet vendore<sup>13</sup>. Për të siguruar ndërlidhje të forta dhe të qëndrueshme, është e domosdoshme që OSHC-të të kenë më së pari qëndrueshmëri financiare me qëllim përmbushjen e angazhimeve të marra ndaj komunitetit në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë.

Nga ana tjetër, OSHC-të duhet të kenë informacion të përditësuar në lidhje me gjendjen në të cilën ndodhet baza e mbështetësve të tyre, si dhe nevojat që ata paraqesin e që duhen adresuar. Për grumbullimin dhe analizimin e këtij informacioni, OSHC-të deklaruan se mjeti kryesor që ato përdorin, e vlefshme kjo për të katër rajonet, ishin takimet periodike me përfaqësues të komunitetit apo grupeve të interesit, kontaktimi i pikave të kontaktit si dhe krijimi i një databaze ku ruhet informacion i përditësuar mbi këto grupe (Grafiku 19).

<sup>12</sup> Ku vlerësimi 1 –nevojë shumë e lartë dhe 5–nevojë e papërfillshme


<sup>13</sup><https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>

**Grafiku 19: Mjetet që përdor organizata për të vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me bazën e mbështetëseve**



Takimet periodike me përfaqësues të komunitetit apo grupeve të interesit/aktivistë, organizimi i sesioneve të veçanta të diskutimeve, organizimi i fokus grupeve apo edhe anketa/sondazhe online, analizimi i të dhënave dytësore/intervista individuale (klinike), listohen si mënyrat më efektive për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe grupeve specifike, interesat e të cilave përfaqësohen nga OSHC-të (Grafiku 20).

**Grafiku 20: Format e përdorura për identifikimin e nevojave të grupeve që përfaqësojnë organizatat**




## Pjesëmarrja e organizatave në nisma që synojnë fuqizimin e qytetarëve

Pritet që organizatat e shoqërisë civile të jenë zëri i fuqishëm në artikulumin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve. Nga ky studim vihet re se, përveç disa OSHC-ve të cilat e kanë konsoliduar tashmë punën e tyre, 3/4 e OSHC-ve të pyetura (74%) kanë pranuar se nuk janë përfshirë asnjëherë në procese të rëndësishme legjislative (hartim ligjesh, dokumente politikash publike, strategji etj); 7 në 10 organizata (72%) nuk janë angazhuar asnjëherë në organizim referendumesh/ peticionesh. Rajoni i Vlorës shënon përqindjen më të lartë (50%) të përfshirjes së organizatave në nisma që fokusohen tek përfshirja e qytetarëve në procesin e propozimit të akteve/ligjeve, ndërsa përqindjen më të ulët (16%) e shënon rajoni Tiranës Grafiku 21. Për sa i përket mbështetjes për organizim referendumesh/peticionesh, përqindja e pjesëmarrjes është pothuajse e njëtrajtshme në të gjitha rajonet. Ndërkohë që ka një përqindje të lartë të organizatave në të gjitha rajonet të cilat deklarojnë se nuk janë përfshirë në asnjë nismë për fuqizimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në rajonin e Shkodrës organizatat kanë listuar edhe një sërë nismash të tjera, të cilat synojnë fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare si roli i qeverisjes vendore, angazhim në identifikimin e problematikave komunitare, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me OSHC të tjera në nismën e diferencimit të mbetjeve etj. Ndërsa në rajonet Tiranë dhe Elbasan OSHC-të janë përfshirë në nisma që lidhen me edukimin, fuqizimin e të rinjve, përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, ndërgjegjësim etj.

**Grafiku 21: Përfshirja e organizatave në nisma që kanë në themel fuqizimin e qytetarëve për t'u përfshirë në procese demokratike të drejtpërdrejta**




60% e organizatave deklarojnë se janë përfshirë në procese avokimi për çështje vendore, nga të cilat 4/5 e organizatave në rajonin e Shkodrës dhe më shumë se 2/3 në rajonin e Vlorës. Në rajonet e Tiranës dhe Elbasanit më pak se gjysma e organizatave raportojnë që kanë marrë pjesë në proceset avokuese për çështjet vendore. Këto tregues japin indikacionin të një niveli të lartë të pjesëmarrjes në nisma avokuese, por që jo domosdoshmërisht ka rezultuar në rritje të cilësisë në këtë aspekt.

Në përgjithësi, sa i përket kapaciteteve për avokim për çështje vendore, ka nevojë për mbështetje dhe forcim të mëtejshëm. Çështjet vendore zakonisht përfshijnë procese të ndërlikuara vendimmarrjeje, ku janë të përfshira shumë institucione dhe aktorë lokalë. Organizatat nevojitet të kenë njohuri të detajuara për strukturat dhe proceset vendore për të bërë avokimin efektiv.


Avokimi për çështje vendore kërkon njohuri të thella për taktikat e lobimit, strategjitë komunikuese dhe mënyrat efikase të ndarjes së njohurive. Për të ndikuar në vendimmarrje, organizatat nevojitet të dinë si të ndajnë mesazhe dhe të bindin aktorët kyç. OSHC-të, duke qenë të kufizuara në burime njerëzore, financiare dhe teknike, nevojitet të kenë staf të përgatitur/trajnuar dhe të angazhuar, si dhe të kenë qasje në mjete dhe kanale komunikimi dhe teknologji moderne pasi shpesh avokimi në nivel vendor krijon rezistencë nga ana e autoriteteve vendore. Organizatat nevojitet të kenë aftësinë për të përballuar sfida të tilla dhe për të kërkuar përkrahje politike në nivel vendor dhe qendror. Ndikimi në opinionin publik nga ana tjetër dhe mediat lokale është pjesë e rëndësishme e avokimit për organizatat lokale. Ato nevojitet të zhvillojnë strategji komunikimi në mënyrë që të ndikojnë opinionin publik dhe mbështetjen publike.

**Grafiku 22: Përfshirja e organizatave në procese advokimi për çështje lokale**




Të gjitha organizatat që kanë deklaruar se janë përfshirë në procese avokimi (60% sipas grafikut 23) pohojnë se janë bërë pjesë e fushatave të avokimi të ndërmarra nga dy organizata (11% sipas grafikut 24) ose më shumë organizata (48% sipas grafikut 24). Ndërkohë që 1/10 pranojnë se nuk kanë marrë pjesë kurrë në procese advokimi.

**Grafiku 23: Përfshirja e organizatave në fushata advokimi të ndërmarra nga një ose disa organizata**



Pa ndërtimin e koalicionit strategjik, pa rrjetëzim dhe koordinim mes OSHC-ve, ndikimi i organizatave të shoqërisë civile në proceset legjislativë dhe të politikave mbetet i kufizuar<sup>14</sup>. Për të fuqizuar ndikimin e OSHC-ve dhe për të ndërtuar një koalicion strategjik të suksesshëm, është e rëndësishme që OSHC-të të kenë një qasje koordinuese dhe të përdorin rrjetëzimin për të bashkuar burimet dhe fuqitë. Kjo sjell ndryshime të rëndësishme në politikat dhe proceset legjislativë në vend. Sipas të dhënave të grumbulluara, konstatohet se OSHC-të vendosin bashkëpunime kryesisht me organizata që punojnë në të njëjtën zonë, me organizata që punojnë në zona të tjera, me organizata kombëtare, sidomos rajoni Tiranë dhe Elbasan dhe kanë me pak bashkëpunime me organizata rajonale dhe me organizata ndërkombëtare.


**Grafiku 24: Bashkëpunimi me organizatat e tjera**



<sup>14</sup><https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>

Të gjitha organizatat kanë deklaruar se kanë bashkëpunuar qoftë edhe një herë me organizata të tjera, ndërkohë që shohim se për ndërtimin e partneriteteve OSHC-të përdorin mjete dhe metoda të ndryshme. Më së shumti ato përdorin mediat dhe rrjetet sociale, rrjetëzimin, vendosjen e partneritetit bazuar në marrëveshje, ndërtimin e marrëdhënieve me publikun (kryesisht e vërejtur në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër). Është raportuar gjithashtu edhe një rast kur OSHC ka lidhur marrëveshje me organet dhe institucionet e shëndetit publik, por nuk janë specifikuar të dhëna të tjera.

**Grafiku 25: Mjetet që përdorin organizatat për ndërtimin e partneriteteve**




Nëse i referohemi të dhënave lidhur me kategorinë e çështjeve për të cilat organizatat kanë avokuar sipas llojit të veprimtarisë së tyre, vërejmë se në të gjitha rajonet OSHC-të kanë avokuar më së shumti për çështje që lidhen me integrimin e të rinjve (23%), të drejtat e grave dhe barazia gjinore (19%), të drejtat e njeriut (17%), integrimi i komunitetit rom/egjiptian(9%). Për sa i përket advokimit për çështjet e arsimit dhe shëndetësisë, duket se organizatat janë pak të angazhuara pasi vetëm 10% kanë marrë pjesë në fushata avokimi në sektorin e arsimit dhe 9% në atë të shëndetësisë. Sektorët e shëndetësisë dhe arsimit kërkojnë njohuri specifike dhe ekspertizë për të adresuar sfidat dhe për të ndikuar në politikat dhe praktikat ekzistuese. Shëndetësia dhe arsimit janë fusha më komplekse që përfshijnë shumë aspekte të ndryshme, duke përfshirë infrastrukturën, burimet njerëzore, financiare dhe politikat e ndryshme. Kjo bën që organizatat të ndiejnë nevojën e forcimit të kapaciteteve të tyre për të adresuar të gjitha sfidat e këtyre fushave në mënyrë efektive në komunitetet ku ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Disa hapa të mundshëm për të përmirësuar këtë situatë janë:



- **Sensibilizimi dhe Informimi** - OSHC-të nevojitet të zhvillojnë fushata të sensibilizimit dhe informimit për rëndësinë e angazhimit në fushën e shëndetësisë dhe arsimit. Kjo mund të realizohet përmes organizimit të punëtorive, seminareve dhe fushatave të ndryshme të komunikimit.
- **Bashkëpunimi me Ekspertë dhe Organizata të tjera** - OSHC-të nevojitet të bashkëpunojnë me ekspertë në fushën e shëndetësisë dhe arsimit, si dhe me organizata të tjera që janë të specializuara në këto çështje. Kjo do të ndihmojë në ndërtimin e njohurive dhe forcimin e impaktit në komunitet.
- **Krijimi i Partneriteteve Lokale** - OSHC-të nevojitet të krijojnë partneritete lokale me autoritetet vendore, shkolla, spitale dhe institucione të tjera shëndetësore, median të cilat kanë ndikim në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Kjo do të ndihmojë në ngritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit në çështjet kyçe.
- **Fokusimi në Nevojat e Komunitetit** - OSHC-të duhet të përqendrohen në identifikimin e nevojave të veçanta të komunitetit në fushën e shëndetësisë dhe arsimit dhe të krijojnë projekte dhe programe që përmbushin këto nevoja.
- **Përdorimi i Mediave Sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit** - Bashkëpunimi dhe ngritja e urave të komunikimit me median lokale, përdorimi i mediave sociale dhe platformave të tjera të komunikimit do të ndihmojnë OSHC-të të ndajnë mesazhet e tyre për avokimin dhe angazhimin në fushën e shëndetësisë dhe arsimit me një audiencë më të gjerë.


Ka dhe fusha të tjera për të cilat OSHC-të kanë avokuar, siç janë mjedisi, problematikat e bujqësisë dhe blegtorisë, bimët medicinale, qeverisja e mirë etj.

**Grafiku 26: Kategorizimi i çështjeve për të cilat organizatat kanë avokuar sipas fushave:**



43% e organizatave kanë pranuar se iniciativat e tyre avokuese nuk kanë arritur të sjellin ndryshimet e pritura dhe të ndikojnë në opinionin publik dhe/ose në proceset vendimmarrëse, ndërkohë që në rajonet e Durrësit dhe Elbasanit shkon përkatësisht në nivelin 59% dhe 54%. Çështjet për të cilat OSHC-të kanë advokuar më shumë lidhen kryesisht me çështjet e të rinjve, dhunën në familje, mjedisin, ndihmën ndaj familjeve në nevojë, integrimin e komunitetit rom/egjiptian, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve, buxhetimin gjinor, buxhetimin me pjesëmarrje etj

**Grafiku 27: A keni arritur të sillni ndryshime pozitive duke ndikuar në opinionin publik dhe/ose në proceset vendimmarrëse**






## Konsultimi publik dhe aksesimi në informacion

Legjislacioni kryesor që mundëson pjesëmarrjen e OSHC-ve në vendimmarrje është Ligji Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik, duke përshkruar përgjegjësitë e institucioneve publike për të mundësuar kontributin e publikut, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e vendimmarrjes për ligjet, dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore dhe çështje të tjera të politikave publike.

Institucionet duhet të sigurohen që aktorëve kryesorë dhe publikut të gjerë t’u jepet njoftimi paraprak për proceset e konsultimit publik, duke u dhënë kohë të mjaftueshme dhe të krijojnë mekanizmat e duhur për thithjen e mendimeve dhe opinioneve edhe pas procesit. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje do të jetë e informuar, gjithëpërfshirëse dhe me ndikim të konsiderueshëm. Për më tepër, organet publike duhet të përfshijnë në mënyrë aktive OSHC-të jo vetëm në njoftimin e projektligjeve, por edhe gjatë procesit fillestar të hartimit të akteve përkatëse.

Sipas të dhënave në Grafikon 28, rezultojnë se rreth gjysma e organizatave (48%) kanë njohuri të mira mbi Ligjin “Për Konsultimin Publik”; në rajonin e Shkodrës dhe Vlorës 3 në 5 organizata e njohin Ligjin; në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër vetëm 2 në 5 organizata pranojnë se e njohin ligjin, ndërsa në rajonin Elbasan-Korçë-Berat numri I organizatave që deklarojnë se kanë dijeni për ligjin janë vetëm 3/10.


**Grafiku 28: Sa e njohin organizatat Ligjin „Për Konsultimin Publik“?**



Grafiku 29 tregon se periudha kur OSHC-të janë përfshirë më shumë në konsultime në nivel qendror ka qenë gjatë dy viteve të fundit, ndërkohë për konsultimet në nivel vendor rezultojnë se OSHC-të janë angazhuar më shumë në 10 vitet e fundit si dhe gjatë vitit të fundit. Kërkesat e ngritura nga OSHC-të në kuadër të proceseve të konsultimit janë kryerë gjithësisht për çështje që shqetësojnë dhe problematikat që shqetësojnë bazën e tyre të mbështetësve dhe komunitetet vendore. Ato gjithashtu janë fokusuar në ndryshimet e ligjit për të drejtën e informimit, programe integrimi për komunitetin rom/egjiptian, draft-

planin strategjik për të rinjtë, shërbimet te integruara sociale, draft-plani për edukimin ligjor, programin e bonusit të qirasë për familjet në nevojë, gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje, grupet vulnerabël, personat me aftësi ndryshe etj.


**Grafiku 29: Përfshirja e organizatave në konsultime në nivel lokal dhe qendror**



Përfshirja në mënyrë aktive e OSHC-ve jo vetëm në njoftimin e projektligjeve/akteve, por edhe gjatë procesit fillestar të hartimit të akteve përkatëse është thelbësor, pasi procesi i konsultimit nuk lidhet thjesht me ndarjen e informacionit dhe organizimin e takimeve, por është një proces i vazhdueshëm i angazhimit të OSHC-ve përgjatë të gjithë fazave që ndjek konsultimi publik.


Treguesit në Grafikon 30 tregojnë se mbi gjysma e organizatave (53%) nuk janë përfshirë asnjëherë në procese draftimi apo diskutimi të projekt-akteve nga Bashkia/Qarku ku ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Sipas rajoneve, situata shfaqet: në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës dhe Vlorë-Fier-Gjirokastrë 40% e organizatave nuk kanë marrë pjesë asnjëherë; në rajonin Elbasan-Korçë-Berat 62% dhe në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër 71%.

Grafiku 30: Përfshirja e organizatave në draftimin/diskutimin e projekt-akteve nga Bashkia, Qarku



Nga ana tjetër, përfshirja e OSHC-ve në konsultimet publike të buxhetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore duket se është në nivele të larta (90%) në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës, e pasuar nga rajoni Vlorë-Fier-Gjirokastrë (60%) dhe Tiranë-Durrës-Dibër (53%). Ndërkohë rajoni Elbasan-Korçë-Berat shënon nivelin më të ulët të përfshirjes së OSHC-ve në konsultimet publike të buxhetit të bashkive me 38%.

**Grafiku 31: Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në konsultimet publike të Buxhetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore**




Transparenca e institucioneve publike shqiptare rregullohet me anë të Ligjit Nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”. Në ligj parashikohen kërkesat për transparencë për autoritetet publike, dispozita për kërkesa për lirinë e informacionit (FOI) dhe mekanizmat e monitorimit.

Transparenca, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje dhe integriteti janë pjesë integrale të një kuadri të plotë anti-korrupsion. Iniciativat që më së shumti lidhen me transparencën përfshijnë promovimin e ndarjes së informacionit/aksesit në informacion publik për një sërë procesesh të institucioneve në nivel qendror dhe vendor në sektorë të ndryshëm, siç janë shëndetësia, arsimi, infrastruktura etj. Qasjet që promovojnë transparencën dhe pjesëmarrjen bëhen efektive vetëm nëse ato kombinohen me forma më tradicionale të llogaridhënies, siç janë monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e institucioneve nga OSHC-të, qytetarët, media etj.

Vetëm nëse kemi qytetarë të informuar, të ndërgjegjësuar në lidhje me të drejtat e tyre, mund të flasim për llogaridhënie efektive të institucioneve publike për vendimet që ato marrin, veprimet që kryejnë apo edhe për menaxhimin e fondeve publike. Transparenca pa fuqizimin e përfituesve të drejtpërdrejtë për të marrë pjesë në vendimmarrje në të gjitha fazat e saj, pra që nga momenti i planifikimit deri në miratimin përfundimtar nuk mund të prodhojë dhe sigurojë përgjegjshmëri dhe reagim në politikat publike.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara dhe analizuara, rezulton se 9 në 10 organizata të pyetura në rang vendi deklarojnë se kanë njohuri të mira mbi Ligjin Nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

**Grafiku 32: Sa organizata kanë njohuri mbi Ligjin Për të Drejtën e Informimit?**




Ligji ‘Për të Drejtën e Informimit’ parashikon dhe mekanizmin kontrollues për ato autoritete publike të cilat dështojnë ose nuk pranojnë të japin informacionin e kërkuar pa dhënë arsye dhe ky mekanizëm ushtrohet nëpërmjet paraqitjes së ankesës nga kërkuesi i informacionit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka autoritetin dhe kompetencën ta detyrojë institucionin të japë informacionin ose të vendosi sanksione administrative (gjyba) në rast të refuzimit për të dhënë informacion. Instrumenti i “ankesës” është një mjet në duart e kërkuesit të informacionit për t’u kërkuar llogari autoriteteve publike dhe për t’i mbajtur përgjegjës për veprimet apo mosveprimet në raport me sigurimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë.

Por, kur OSHC-të u pyetën nëse kishin paraqitur ndonjëherë ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në rastet kur institucionet kishin refuzuar t’i përgjigjeshin kërkesës për informacion, më shumë se 4 në 5 organizata (84%) deklaruan se nuk kishin bërë asnjëherë ankim pranë KDIMDhP, respektivisht 90% e organizatave në rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës, 76% në rajonin Tiranë-Durrës-Dibër, 92% në Elbasan-Korçë-Berat dhe 80% në Vlorë-Fier-Gjirokastrë. Ankesat e paraqitura pranë KDIMDP ishin ndaj bashkive për moskthim përgjigjeje dhe disa institucioneve publike në nivel qendror si Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Institucionet e trashëgimisë kulturore, Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor Rural etj.

Pavarësisht se OSHC-të kanë njohuri të mira në lidhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, ato rezultojnë se kanë mangësi në ushtrimin në praktikë të të drejtës për t’u ankuar. Ushtrimi i kësaj të drejte është e rëndësishme për OSHC-të që synojnë të ndikojnë në përmirësimin e transparencës dhe qasjes së qytetarëve në informacionin publik. Për këtë, OSHC-ve iu nevojiten trajnime të posaçme me qëllim që të kuptojnë

procedurat dhe mënyrat e ushtrimit të kësaj të drejte, duke përfshirë kërkesat për informacion, procesin e ankesave dhe të drejtat e qytetarëve për të marrë përgjigje të saktë dhe në respektim të afateve ligjore nga institucionet publike. Këto trajnime i ndihmojnë OSHC-të të përmirësojnë nivelin e ndërgjegjësimit të tyre dhe njohuritë për procedurat dhe standardet në lidhje me qasjen në informacion publik. Trajnime në këtë fushë i ndihmojnë OSHC-të të ndihmojnë qytetarët të kenë më shumë informacion dhe të jenë më të informuar për punën e institucioneve publike, duke përmirësuar kështu transparencën dhe përgjegjshmërinë.

**Grafiku 33: A i janë drejtuar organizatat me kërkesë/ankesë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale**



# KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet e vlerësimit të kapacitetit të OSHC-ve, ky seksion përmbledh përfundimet e vlerësimet dhe rekomandimet e lidhura me to.

## KONKLUZIONE



### 01 — Shumica e organizatave punojnë në më shumë se një sektor

Shumica e organizatave punojnë në më shumë se një sektor dhe merren me çështje ndërsektoriale, duke përfshirë çështjet sociale, të drejtat e njeriut, zhvillimi rural, ndihma për fëmijët dhe të moshuarit, gratë etj. 1 në 3 organizata deklarojnë se kanë në fokus të tyre, ndër të tjera, edhe sektorin e arsimit. Kryesisht organizatat janë të angazhuara për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve nga grupet vulnerabel në sistemin arsimor dhe asnjëra prej tyre nuk është përfshirë në aksione të fokusuar në monitorimin e punës së institucioneve arsimore apo që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien në këtë sektor.



### 02 — OSHC në sektorin shëndetësor

1 në 6 organizata (16%) deklarojnë se trajtojnë edhe çështje të lidhura me sektorin shëndetësor, por qasja e tyre është e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me aksesin e grupeve vulnerable, kryesisht personave me aftësi ndryshe dhe romëve-egjiptianëve, në sistemin shëndetësor për marrjen e shërbimeve cilësore dhe asnjëra prej tyre nuk është përfshirë në aksione që kanë të bëjnë me transparencën dhe llogaridhënien e strukturave shëndetësore.



### 03 — OSHC e përfshira në procese legislative

3/4 e OSHC-ve nuk janë përfshirë asnjëherë në procese të rëndësishme legislative (hartim ligjesh, dokumente politikash publike, strategji etj); 7 në 10 organizata (72%) nuk janë angazhuar asnjëherë në organizim referendumesh/ peticionesh.



### 04 — OSHC e përfshira në advokaci dhe lobim

Edhe pse 60% e organizatave deklarojnë se janë përfshirë të paktën një herë në procese avokimi për çështje të caktuara, vetëm 10% e OSHC-ve kanë marrë pjesë në fushata avokimi në sektorin e arsimit dhe 9% në atë të shëndetësisë. Organizatat janë fokusuar kryesisht në çështje që lidhen me integrimin e të rinjve, të drejtat e grave dhe barazia gjinore, të drejtat e njeriut, integrimi i komunitetit rom/egjiptian etj.



### 05 — OSHC e përfshira në advokaci dhe lobim

43% e organizatave që deklarojnë se kanë marrë pjesë në procese avokimi kanë deklaruar se iniciativat e tyre avokuese nuk kanë arritur të sjellin ndryshimet e pritura dhe të ndikojnë në opinionin publik dhe/ose në proceset vendimmarrëse, ndërkohë që në rajonet e Durrësit dhe Elbasanit shkon përkatësisht në nivelin 59% dhe 54%.



### 06 — Përfshirja e OSHC-ve në konsultimet publike

Rreth gjysma e organizatave (48%) deklarojnë se kanë njohuri të mira mbi Ligjin “Për Konsultimin Publik”, ndërsa 53% pranojnë se nuk janë përfshirë asnjëherë në procese draftimi apo diskutimi të projekt-akteve nga Bashkia/Qarku ku ato ushtrojnë veprimtarinë e tyre.



### 07 — Konsultimi publik dhe aksesimi në informacion

9 në 10 organizata deklarojnë se kanë njohuri të mira mbi Ligjin “Për të Drejtën e Informimit”, më shumë se 4 në 5 e OSHC-ve (84%) pranuan se nuk kishin bërë asnjëherë ankim pranë KDIMdHP për institucionet publike që refuzojnë të japin informacion.



### 08 — Bashkëpunimi i OSHC-ve me median lokale

Vetëm 1 në 10 organizata veprojnë mbi një plan strategji komunikimi ose një dokument tjetër të ngjashëm me të. Ato shprehin nivel të ulët bashkëpunimi me mediat për rritjen e informimit dhe komunikimit me publikun dhe grupet e interesuara.





## REKOMANDIME



OSHC-të duhet të intensifikojnë angazhimin, avokimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin në lidhje me shëndetësinë dhe arsimin, duke ngritur kapacitetet e tyre të brendshme nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimeve që përfshijnë aftësitë e planifikimit strategjik dhe menaxhimit të projekteve; qëndrueshmërisë financiare dhe diversifikimi i burimeve të financimit; hartimin dhe zbatimin e projekteve inovative, hartimi dhe zbatimi i planeve strategjike të komunikimit, si dhe përdorimin i teknologjisë. Ato duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre për avokim, lobim dhe ndikim politik kryesisht në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë.

OSHC-të nevojitet të krijojnë partneritete lokale me autoritetet vendore, shkollat, spitalet dhe institucionet e tjera shëndetësore dhe median, të cilat kanë ndikim në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Kjo do të ndihmojë në ngritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit në çështjet kyçe.



OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me rrezikun dhe ndikimin e korrupsionit në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, nëpërmjet ndërmarrjes së aksioneve që nxisin transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve në që veprojnë në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë me fokus parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në këta sektorë.

Angazhimi aktiv i OSHC-ve në proceset e konsultimit publik në nivel vendor të projekt-akteve ligjore dhe nënligjore, buxheteve vendore të bashkive ku operojnë dhe krijimin e aleancave strategjike me OSHC të tjera që veprojnë në fusha që lidhen direkt apo indirekt me shëndetësinë dhe arsimin.





OSHC-të duhet të mbështeten për të përmirësuar kapacitetet e tyre në marrëdhëniet me publikun, hartimin e strategjive të komunikimit, si dhe përdorimin e teknologjisë, duke përfshirë rrjetet sociale dhe platformat online, të cilat ndihmojnë në mobilizimin e rinisë dhe komunitetit për të rritur angazhimin në luftën kundër korrupsionit dhe për të ndikuar në politikat dhe proceset vendimmarrëse. OSHC-të në bashkëpunim me media lokale të zbatojnë fushata informimi dhe ndërgjegjësimi me fokus luftën kundër korrupsionit në sistemin arsimor dhe shëndetësor.

Ofrimi i trajnimeve të posaçme për OSHC-të sa i takon zbatimin praktik të ligjit “Për konsultimet publike” dhe ligjit “Për të drejtën e informimit”, me qëllim njohjen dhe përdorimin efikas të mjeteve ligjore për monitorimin dhe kontrollin e institucioneve publike, veçanërisht në sektorin arsimor dhe shëndetësor, dhe përfshirjen e tyre gjatë të gjithë ciklit të hartimit dhe zbatimit të programeve dhe politikave publike me impakt të gjerë.



## BIBLIOGRAFIA

- Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri, 2019  
<http://www.partnersalbania.org/publication/vleresimi-i-kapaciteteve-dhe-nevojave-te-organizatave-te-shoqerise-civile-ne-shqiperi/>
- UNDP- Vlerësimi i kapaciteteve dhe i nevojave për trajtim të OSHC-ve që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar  
<https://www.undp.org/albania/publications/capacity-and-training-needs-assessment-csos-ëorking-area-disabilities>
- Komisioni Evropian- Raporti për Shqipërinë 2022  
[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en)
- Komisioni Evropian- Raporti Screening për Shqipërinë 2023  
[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en)
- IDM, Pjesëmarrja e OSHC-ve në Vendimmarrje në Shqipëri  
<https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf>
- INSTAT, Punësimi në Shqipëri  
<https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/pun%C3%ABsimi-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030  
[https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Kombetare-e-Shendetesise-2021-2030\\_compressed.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Strategjia-Kombetare-e-Shendetesise-2021-2030_compressed.pdf)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Plani i Integritetit  
<https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/urdher-nr.-267-per-miratimin-e-planit-te-integritetit-te-MSHMS-2022-2025.pdf>
- Ministria e Arsimit, Strategjia për Arsimin 2021-2026  
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>
- Ministria e Arsimit, Plani Integritetit  
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/PI-e-Risqeve-MAS-26-04-22.pdf>
- Ministria e Drejtësisë, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020  
[https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/6.-STRATEGJIA-ND%C3%8BRSEKTORIALE-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT-2015-2020\\_AL.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/6.-STRATEGJIA-ND%C3%8BRSEKTORIALE-KUND%C3%8BR-KORRUPSIONIT-2015-2020_AL.pdf)
- Urdhër nr. 155, datë 15.10.2018 i Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor” (variant i printuar)